



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-600
Datë: 21.11.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 03.11.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet dhe Kolegji “Tempulli SH.P.K.”, në Prishtinë me adresë Rr.Eduard Lir nr.158, Arbëria, për periudhën 03.11.2017 deri 03.11.2020 me kualifikimin:
 - 1.1.Trafik Rrugor, Niveli IV sipas KKK me 42 kredi të AAP.**
2. Validimi dhe akreditimi dhe i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:
 2. 1. Të azhurnohet Raporti i Vetëvlerësimit (sidomos tek çështja e nivelit që duhet të ishte Niveli 4 i KKK deri sa ne RVV është V;
 2. 2. Numri total i kredive është paraqitur 60 – që duhet të ishte 42 sipas 420 orëve të parapara, andaj të përmirësohet ne te gjitha dokumentet e paraqitura;
 2. 3. Modulet e nevojshme të ripërpunohen dhe riemërtohen duke ju përshtatur Nivelit 4 KKK: Teoria e lëvizjes dhe Mekanizmat ngarkues;
 2. 4. Të ndryshohen kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve. Nuk mund të regjistrohen kandidat me shkollim të mesëm të ulët.
 2. 5. Nga vlerësimi jonë rezulton se ka ngjashmëri me drejtime të profileve të ngjashme. Të sqarohen dhe arsyetohen ngjashmëritë.
 2. 6. Zyra e cilësisë duhet të përcaktoj rregullore në pajtim me rregulloret ne fuqi për njohje të kredive nga kualifikimet e marra prej institucioneve tjera.

- 2.7. Rekomandohet që të plotësohet procedura për pranim të kandidatëve me detaje që krijojnë besimin dhe zbatimin e qasjes objektive dhe të barabartë në ofrimin e mundësive të përzgjedhjes.
- 2.8. Obligohet menaxhmenti që të gjitha dokumentet procedurale, rregulloret, politikat që i ka parashtruar në kuadër të dosjes të firmos dhe vulos për të marr peshën e tyre juridike para AKK.
- 2.9. Të përtërihen marrëveshjet e bashkëpunimit, të freskohen dhe zbatohen nga menaxhmentet aktuale për të siguruar vazhdimësinë e kooperimit jo vetëm formal.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 20.12.2017 sipas raportit të jashtëm vlerësues për kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
- Kolegji "Tempulli";
- AKK.

Bedri Khafa
Kryetari i KD së AKK-së

